



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë Europcar Mobility Group S.A nga shoqëria Volkswagen Finance Luksemburg S.A dhe Trinity Investments Designated Activity Company.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 385prot. i AK, datë 27.08.2021, “Përqendrimi ndërmjet Volkswagen Aktiengesellschaft/Trinity Investments Designated Activity Company/Europcar Mobility Group S.A”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e përfitimit të kontrollit të përbashkët mbi shoqërinë Europcar Mobility Group nga shoqëria Volkswagen Aktiengesellschaft dhe Trinity Investments Designated Activity Company.

Referuar dokumentit “Kontratë Kuadër Transaksioni” të lidhur më datë 28 korrik 2021, palët janë:

Pala 1: Volkswagen Finance Luksemburg S.A është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas ligjeve të Luksemburgut, me objekt aktiviteti: pjesëmarrje në shoqëri vendase dhe të huaja, ose në shoqëri të çfarëdo lloji, si dhe të menaxhojë këto pjesëmarrje, të marrë pjesë në krijimin, zhvillimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e çdo shoqërie ose ndërmarrje, etj.

Volkswagen Finance Luksemburg S.A, zotërohet tërësisht nga Volkswagen Aktiengesellschaft dhe është në pronësi të plotë të Grupit Volkswagen.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes 2 filialeve *Porsche Leasing dhe SHPK Porsche Albania SHPK*

Pala 2: Trinity Investments Designated Activity Company, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Irlandës, me aktivitet të përcaktuar në përputhje me ligjin irlandez “Për shoqëritë Tregtare”, e themeluar për një qëllim të caktuar, aksionet e të cilit zotërohen nga Trinity Investments Charitable Trust.

Trinity nuk ka asnjë seli ligjore të regjistruar në Shqipëri.

Pala 3: Pon Holdings B.V, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit holandez, me objekt aktiviteti: Aktivitet financiar, ofrim i burimeve njerëzore(nuk ka projekte punësimi).

Pala 4: Green Mobility Holding S.A (Bid Co), është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Luksemburgut, me objekt aktiviteti: pjesëmarrëse në shoqëri vendase dhe të huaja, ose në shoqëri të çfarëdo lloji, si dhe të menaxhojë këto pjesëmarrje. Volkswagen

Aktiengesellschaft përmes filialit të tij Volkswagen Finance Luksemburg S.A krijoi shoqërinë Green Mobility Holding.

Pala 5: Attestor Value Master Fund LP, është një partner i kufizuar i themeluar sipas ligjeve të ishullit Kaiman, Island (garantor i shoqërisë Trinity Investments Designated Activity Company).

Target: Europcar Mobility Group S.A, është një shoqëri aksionare, franceze, me objekt aktiviteti: çdo blerje aksionesh ose interesash në ndonjë person juridik francez ose të huaj, si dhe çdo aktivitet që ka të ngjarë të kryhet nga një shoqëri holding – ku shoqëria merr pjesë, me çdo mjet, në çdo operacion që mund të lidhet me qëllimin e saj ose nëpërmjet krijimit të shoqërive të reja, etj.

Europcar Mobility Group S.A, nuk ka filial të regjistruar në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.